

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2023

Nr. Rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	04.01.2023	Vlerat 40,42, sipas formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit të llogaritur në bazë vjetore për gjithë subjektet, për vitet 2019,2020,2022.	11.01.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Viti 2019 - rub. 40 nr.336; rub 41 vlerë 100,800,000 Viti 2020 – rub. 40 nr.280; rub 41 vlerë 84,000,000 Viti 2022 – rub.40 nr.198; rub 41 vlerë 59,400,000 Viti 2019 - rub. 42 nr.72; rub 43 vlerë 108,000,000 Viti 2020 – rub. 42 nr.280; rub 43 vlerë 90,000,000 Viti 2022 – rub. 42 nr.198; rub 43 vlerë 99,000,000	E plotë	Nuk ka
2	05.01.2023	Kopje të raportit të auditimit të shoqërisë 'X' dhe 'X' dhe sanksionet e aplikuara.	09.01.2023	Në nenin 25 'Konfidencialiteti', të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, 'Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar, nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës'.	E refuzuar	Nuk ka
3	09.01.2023	Nuk arrijë të logohem në e-filing pasi dua të bëj deklaratën e dypunësimit. Informacion si të bëj reset pasëordin?	17.01.2023	Rivendosja e fjalëkalimit, është shërbimi online, i cili i është shtuar listës së shërbimeve online të DPT-së, tashmë të konsoliduara prej vitesh. Ky shërbim përfitohet nga	E plotë	Nuk ka

				tatimpaguesit apo individët e regjistruar në portalin e-albania. Bashkëngjitur Udhëzues përdorimi mbi mënyrën e përdorimit të shërbimit “Rivendosje Fjalëkalimi për tatimpagues të regjistruar”		
4	12.01.2023	Sa është numri i organizatave jofitimprurëse aktive në vendin tonë? Sa është numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në total në vendin tonë?	16.01.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë: Numri i organizatave jofitimprurëse aktive është 2278. Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në total është 5420.	E plotë	Nuk ka
5	16.01.2023	Sa është numri i subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e artizanatit në vendin tonë përfshirë që gjitha llojet e teknikave.	26.01.2023	Në lidhje me përshkrimin punime/produkte artizanale, nuk ekziston një kod specifik sipas listës së Kodeve Nace 2 që të përfshijë këtë kategori tatimpaguesish. Ndaj është i vështirë identifikimi i saktë i subjekteve që mundësojnë punime/produkte artizanale. Për këtë arsye u identifikuan nga popullata ato subjekte që në përshkrimin e tyre ‘Objekt aktiviteti’ përfshijnë termin artizanal dhe u identifikuan 25 tatimpagues aktiv.	E plotë	Nuk ka
6	18.01.2023	Sa është numri total i organizatave jofitimprurëse (OJF) të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve deri më 31 dhjetor 2022, i ndarë sipas statusit dhe formës ligjore? Sa është numri total i OJF-ve të regjistruara gjatë vitit	31.01.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë: Numri total i OJF-ve të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve deri më 31 Dhjetor 2022 është 5389. Numri total i OJF-ve të regjistruara gjatë vitit kalendarik 2022 është 239. Numri i OJF-ve të cilat kanë qenë subjekt kontrolli nga Administrata Tatimore gjatë vitit kalendarik 2022 është 13 kontrolle.	E plotë	Nuk ka

		<p>kalendariq 2022, i ndarë sipas formës ligjore? Sa është numri i OJF-ve të cilat kanë qenë subjekte kontrolli nga Administrata Tatimore gjatë vitit kalendarik 2022?</p>				
7	18.01.2023	<p>Informacion për shtetasit amerikan që jetojnë në Shqipëri, por të ardhurat i marrin nga Amerika, a duhet të paguajnë tatimin mbi të ardhurat edhe në Shqipëri.</p>	31.01.2023	<p>Referuar rastit të paraqitur nga shtetasi amerikan me rezidencë tatimore në Republikën e Shqipërisë, informojmë se shumën bruto të të ardhurave personale të realizuara jashtë Republikës së Shqipërisë do e pasqyrojë në DIVA (rubrika 13). Referuar dispozitave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 37 "Kreditimi i tatimit të huaj", individit do të reduktojë (kreditojë) në Republikën e Shqipërisë tatimin e paguar jashtë RSH deri në shkallën tatimore të përcaktuar në ligjin vendas (masën 15%).</p>	E plotë	Nuk ka
8	31.01.2023	<p>Sa është informaliteti në tregun e punës? Qarku me informalitetin më të madh?</p>	13.02.2023	<p>Në Administratën Tatimore nuk është bërë vlerësim i hendeut tatimor në vlerësimin e punës, por nga analiza e vetëdeklarimeve të tatimpaguesve është evidentuar një risk potencial në këtë sektor. Nisur nga kjo, Administrata Tatimore ka ndërmarrë një sërë nisma sa i takon uljes së informalitetit në tregun e punës. Shtrirja e fenomenit është e gjerë dhe qarku më problematik vlerësohet Tirana, si qarku me numrin më të madh të të punësuarëve dhe zonat bregdetare gjatë sezonit veror.</p>	E plotë	Nuk ka
9	06.02.2023	<p>A duhet të paguajë TAP një i dypunësuar me pagë neto më</p>	16.02.2023	<p>Në zbatim të dispozitave ligjore tatimore në fuqi, Administrata Tatimore mbledh të</p>	E plotë	Nuk ka

		shumë se 150 mijë lekë, të cilët janë me leje lindje përgjatë 365 ditëve?		<p>ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe transferon shumat në institucionet përkatëse, të cilat janë administrueset e tyre.</p> <p>Gjithashtu, duhet të theksojmë se kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore aplikohen për të ardhurat nga pagat bruto (të ardhura me karakter të perhershëm) dhe aplikimi bëhet mbi pagën minimale (34,000 lekë aktualisht) dhe pagën maksimale (149,954 lekë aktualisht). Ndërsa kontributet e sigurimeve shëndetësore aplikohen mbi pagën minimale (34,000 lekë) dhe paga maksimale nuk ka limit.</p> <p>Institucioni që llogarit të ardhurat që përfitohen gjatë bar-lindjes është Instituti i Sigurimeve shoqërore bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e depozituar nga vetë individi.</p> <p>Në rast se një individ është me leje lindje për mendimin tonë ajo/ai nuk duhet të jetë i punësuar, por për këtë duhet të merret mendimi i institucionit përgjegjës</p>		
10	07.02.2023	Informacion për normën e Rentës Minerale (Grupi IV, Mineralet dhe Materialet e Ndërtimit) gëlqerorët 5 %.	16.02.2023	Përsa kërkohet nga ana juaj përcaktohet në Ligjin Nr.9975, datë 28.7.2008 PËR TAKSAT KOMBËTARE I NDRYSHUAR, neni 4, pika 4. Ndërkohë në UDHËZIM Nr.26, datë 4.9.2008 PËR TAKSAT KOMBËTARE I NDRYSHUAR, pika 2.5 jepen edhe shembuj ilustrues.	E plotë	Nuk ka
11	08.02.2023	Në lidhje me bizneset që qëndrojnë në heshtje përse i përket detyrimeve në Tatime, sa ju kanë rezultuar gjatë vitit	22.02.2023	Nga të dhënat e administruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve gjatë vitit kalendarik 2022 rezultojnë 109,254 subjekte debitore me status pasiv nga	E plotë	Nuk ka

		<p>2022? Cili ka qenë veprimi juaj pasi keni evidentuar mos likuidimin e detyrimeve? Në lidhje me bizneset të cilët kanë diferenca në fatura, ju keni paralajmëruar për penaltitete? Deri në ç'masë do të jenë penaltitetete?</p>		<p>182,379 subjekte debitore gjithsej. Të dhënat datë 31.12.2022.</p> <p>Në zbatim të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Neni 88: "Administrata Tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Administrata Tatimore i ushtron këto kompetenca, duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimalizojë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara".</p> <p>Penaltitetet për deklarim jo të saktë të faturave të shitjes janë të parashikuara në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe aplikohen rast pas rasti në bazë të kontrolleve dhe vlerësimeve tatimore që kryehen nga Drejtoria Rajonale përkatëse.</p>		
12	13.02.2023	<p>Informacion në lidhje me ambientet me qera që ka Administrata Tatimore.</p>	24.02.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Marrja me qera e ambienteve për akomodimin e strukturave të Administratës Tatimore është bërë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	E plotë	Nuk ka

				Përcaktimi i kriterëve që duhet të përmbushin subjektet aplikuese si dhe vlerësimi i tyre bëhet nga komisionet që ngrihen për këtë qëllim.		
13	22.02.2023	Sa është numri i “të sinjalizuarëve” në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme? Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në fjalë?	07.03.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Për vitet 2018-2022, nuk ka patur sinjalizues të regjistruar apo raste të sinjalizuara dhe çdo vit i është raportuar ILDKPKI-së. Sipas parashikimit të Ligjit Nr. 60/2016, “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, KREU VI. Monitorimi i mekanizmit të sinjalizimit, Neni 22. Raportimi. Pika 1. Njësia përgjegjëse zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, si dhe i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	E plotë	Nuk ka
14	06.03.2023	Informacion mbi kartat teknologjike që Autoritetet Tatimore kanë verifikuar bazuar në kontrollin e ushtruara pranë kompanive më me ndikim në tregun shqiptar.	16.03.2023	Në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi, subjektet të cilët për shkak të veprimtarisë/aktivitetit që ushtrojnë duhet të jenë të pajisur me kartë teknologjike, janë të detyruar të vendosin në dispozicion të Administratës Tatimore, kartën teknologjike që disponojnë. Autoritetet tatimore, gjatë kontrollit të ushtruar në vend pranë tatimpaguesit, analizojnë kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit.	E refuzuar	Nuk ka

				Theksojmë se, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Administrata Tatimore është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave tregtare të tatimpaguesit, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrave të saj funksionale.		
15	06.03.2023	Informacion në lidhje me vlerën e TVSH-së dhe taksat totale që ka paguar tatimpaguesi X.	16.03.2023	Në nenin 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave Administrata Tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konstaton se janë kërkuar të dhëna tatimore të subjekteve për të cilat Administrata Tatimore ka detyrimin ligjor të ruajtjes së konfidencialitetit të tyre.	E refuzuar	Nuk ka
16	14.03.2023	Informacion lidhur me mosshfaqjen e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për disa muaj gjatë vitit 2014.	27.03.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se: Pas sistemimit të listëpagesave të tatimpaguesit X, të bëra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, janë gjeneruar detyrime si rezultat i diferencave në deklaram. Për periudhat e kërkuar nga ana juaj, janë bërë sistemimet përkatëse.	E plotë	Nuk ka
17	20.03.2023	Informacion mbi depozitimin e pasqyrave financiare në QKB nëpërmjet portalit e-albania.	24.03.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Bazuar në nenin 42 të Ligjit 9920/2008 për Procedurat Tatimore, në RSH, një OJF	E plotë	Nuk ka

				regjistrohet vetëm në organet tatimore (jo në QKB). Një OJF ka detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare dhe çdo ndryshimi në lidhje me aktivitetin vetëm pranë administratës tatimore.		
18	20.03.2023	Cilat janë gjetjet pas auditimeve të kryera për subjektet X?	31.03.2023	Në nenin 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave Administrata Tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konstaton se janë kërkuar të dhëna tatimore të subjekteve për të cilat Administrata Tatimore ka detyrimin ligjor të ruajtjes së konfidencialitetit të tyre.	Refuzuar	Nuk ka
19	21.03.2023	Sa është numri i call-centera aktualisht? Sa është numri i të punësuarëve aktualisht?	29.03.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Nga baza e të dhënave që disponojmë, në vendin tonë, operojnë aktualisht 509 subjekte aktive me kod Nace 2 "N8220" Aktivitete të qendrave telefonike (call center). Numri i punonjësve sipas listëpagesës së fundit Dhjetor 2022 është 10,801 punonjës për 507 tatimpagues që e kanë deklaruar këtë listëpagesë.	E plotë	Nuk ka
20	27.03.2023	Informacion përsa i përket importeve për makinat elektrike në RSH.	28.03.2023	Në nenin 51 " Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm", shkronjat "p" të ligjit Nr.92/2014, datë 27.07.2014 "Për	E plotë	Nuk ka

				<p>Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar, ligjvënësi ka përjashtuar nga TVSH-ja furnizimin e automjeteve vetëm me motor elektrik, të reja, me zero km e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, përveç atyre të përcaktuara në pikën 7, të nenit 49, të këtij ligji.</p> <p>Pra, nëse automjetet e importuara plotesojnë kushtet, sipas përcaktimit ligjor të sipërpërmëndur janë të përjashtuara nga TVSH-ja në import.</p>		
21	28.03.2023	Informacion mbi deklarin e DIVA-s 2022, për të ardhurat nga qeraja.	11.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju informojmë se: Individit që ka dhënë me qera një pasuri të paluajtshme me qerramës individ (pra, i peregjistruar në administratën tatimore), mundet të paguajë tatimin për të ardhurat personale nga qeraja me deklaratën e tatimit në burim (deklaratë mujore) ose me DIVA.</p>	E plotë	Nuk ka
22	30.03.2023	Informacion mbi detyrimet e papaguara (kamatvonesa) të gjeneruara prej sistemit automatik e-taxing.	11.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Nga verifikimi në sistemin informatik rezulton që individit x ka deklaruar me vonesë DIVA-t për vitin 2012, 2018 dhe 2019. Për të treja këto periudha deklarimi është kryer me datë 09.06.2021 dhe si rezultat është penalizuar me 5,000 lekë për secilin vit.</p> <p>Duhet të theksojmë se, është përgjegjësia e tatimpaguesit (individit) për të hyrë në periudhën përkatëse dhe të deklarojë të ardhurat, tatimet e llogaritura dhe të paguara për atë vit fiskal.</p>	E plotë	Nuk ka

23	30.03.2023	Informacion rreth kushteve dhe kërkesave të nevojshme mbi procedurat e rimbursimit të TVSH-së.	05.04.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Procedura, afatet dhe dokumentacioni i nevojshëm për rimbursimin e TVSH-së në kuadrin e marrëveshjeve financiare, janë të parashikuara në nenin 63 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH, i ndryshuar.	E plotë	Nuk ka
24	04.04.2023	Sa është numri i punonjësve që janë rekrutuar në DPT gjatë periudhës Shkurt-Prill 2023?	18.04.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Rekrutimet për periudhën Shkurt - 05 Prill 2023 situatë faktike pasi jemi akoma në muajin Prill janë rekrutuar 10 punonjës të rinj të Administratës Tatimore Qendrore.	E plotë	Nuk ka
25	04.04.2023	Sa është shuma e detyrimeve që ka aktualisht dhe masat që ka marrë DPT për subjektin 'x'?	11.04.2023	Në nenin 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave Administrata Tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Ndërsa në nenin 25 "Konfidencialiteti", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet se: "Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës."	E refuzuar	Nuk ka

26	04.04.2023	A janë OJF-të të përjashtuara nga taksa e pastrimit, apo ndonjë taksë tjetër vendore?	04.04.2023	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" si dhe pika 2, neni 12 ligjit "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar."	E deleguar	Nuk ka
27	11.04.2023	A duhet të paguajnë sigurime shoqërore dhe shëndetësore për veten e tyre dy persona anëtar themelues të një shoqërie të thjeshtë, të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomik të shërbimit të avokatisë/konsulencës ligjore?	25.04.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë: Referuar rastit të paraqitur nga ky individ sqarojmë se, duhet t'i referohet përcaktimeve të VKM 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar. Në këtë VKM nuk ka përjashtim nga pagimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të individëve (pavarësisht nga kategoria i vetëpunësuar apo i punësuar) pjesëmarrës në një shoqëri/person fizik. Në këtë VKM ka përcaktime për pagën minimale dhe maksimale për të cilën paguhen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.	E plotë	Nuk ka
28	18.04.2023	Informacion mbi tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme.	03.05.2023	Referuar nenit 11 "Kalimi i së drejtës së pasurisë së paluajtshme" të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe pikës 2.3.7 të	E plotë	Nuk ka

				<p>Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 (i ndryshuar) përcaktohet se, fitimi kapital i rezultuar nga kalimi i së drejtës së pasurisë së paluajtshme tokë bujqësore/truall/ndërtesë është e ardhur e tatueshme dhe tatohet me shkallë tatimore 15%. Personi (individ) që kalon të drejtën e pasurisë së paluajtshme është i detyruar të kryejë pagesën e tatimit përpara kalimit të së drejtës. ZRPP është institucioni i cili bën kalimin e të drejtës së pronësisë dhe përpara veprimeve përkatëse duhet të disponojë edhe pagesën e tatimit.</p> <p>Në rastin e dhurimit të pasurisë së paluajtshme do të konsiderohet njësoj sikur pasuria e paluajtshme të ishte shitur dhe personi dhurues duhet të kryejë edhe pagesën e tatimit.</p> <p>Në rastin e dhurimit të pasurisë së paluajtshme kemi përjashtim nga tatimit (pika 11.1 e nenit 8/1 "Të ardhura të përjashtuar të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 i ndryshuar), vetëm për banesat dhe truallin brenda lidhjes gjinore në familje bashkëshort/bashkëshorte dhe fëmijë me kushtin që përfituesi të jetë vetëm një herë.</p> <p>Përsa më sipër, në rast se dhuruesi i pasurisë së paluajtshme nuk është në kushtet e pikës 11.1 të nenit 8/1 të ligjit 8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar), dhuruesi i pasurisë është individ që ka detyrimin të paguajë tatimin për fitimin kapital të realizuar nga kalimi i së drejtës së pasurisë së paluajtshme dhe autoriteti që zbaton dispozitat ligjore dhe</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				nënligjore lidhur me veprimet përkatëse të pagimit të detyrimit tatimor është ZRPP.		
29	24.04.2023	<p>Sa familje bujqësore janë të regjistruara?</p> <p>Sa individë posedojnë kod fermeri?</p> <p>Sa subjekte janë regjistruar me aktivitet në fushën e bujqësisë?</p> <p>Sa ferma bujqësore rezultojnë?</p>	25.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Lidhur me pyetjen e parë Administrata Tatimore nuk e disponon informacionin e kërkuar.</p> <p>Theksojmë se Administrata Tatimore ka të regjistruar ndër vite si Prodhues Bujqësor (Fermer) 92,174 individë, duke sqaruar se këta janë regjistruar direkt në AT vetëm për NIPT dhe nuk paguajnë detyrime tatimore.</p> <p>Administrata Tatimore administron të dhëna në lidhje me këta tatimpagues të regjistruar, vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev2 (Klasën) dhe jo sipas përcaktimeve të cituara nga kërkuesi.</p> <p>Këto të dhëna transmetohen në DPT pas regjistrimit të tatimpaguesve në QKB e cila vendos dhe kodin përkatës katër shifror (klasën).</p>	E plotë	Nuk ka
30	25.04.2023	Informacion pse në "vërtetim për pagesat e kontributeve të individit" më shfaqen vetëm dy muaj.	26.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Referuar sistemit c@ts, individit 'X', rezulton e punësuar në subjektin 'x'. Subjekti nuk rezulton me detyrime në përgjegjësinë tatimore "Kontribute Shoqërore dhe Shëndetësore" si dhe listëpagesat deri për periudhën 2303 kanë statusin "dërguar" në ISSH, pra nuk ka mospërputhje midis pagesave dhe deklarimeve.</p>	E plotë	Nuk ka

31	04.05.2023	Lista e subjekteve të prekura nga tërmetet.	08.05.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se: Administrata Tatimore nuk e disponon informacionin e kërkuar.	E plotë	Nuk ka
32	15.05.2023	Vendosjen në dispozicion të informacionit nëse subjekti X është i pajisur me NIPT (NUIS). Në rast se po, vendosjen në dispozicion të informacionit lidhur me të dhënat e NIPT (NUIS)?	17.05.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se: Nga verifikimi i kryer në sistemin tatimor nuk rezulton asnjë subjekt i regjistruar sipas emërtimeve të dhëna nga ana juaj. Nëse keni ndonjë të dhënë tjetër identifikuese, lutemi na bëni me dije.	E plotë	Nuk ka
33	01.06.2023	Kërkesë për t'u pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja.	01.06.2023	Lidhur me kërkesën për t'u pajisur me autorizim për përjashtimin nga tvsh, të bërë nga subjekti 'X' ju informojmë se, bazuar në këtë kërkesë dhe dokumentacionin e dërguar, ky subjekt është pajisur me autorizimin datë 19.05.2023. Gjithashtu bëjmë me dije se shkresa është dërguar në rrugë zyrtare me postë.	E plotë	Nuk ka
34	06.06.2023	Si e bëjnë deklarin në AT pajisjet e vetëshërbimit (automatet) përse kohë nuk lëshojnë kupon tatimor? Sa është xhiroja e deklaruar nga subjekti 'x' dhe 'x' për vitin 2021 dhe 2022?	19.06.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, në lidhje me mënyrën e deklarimit të shitjeve nga pajisjet e vetëshërbimit (automatet), Administrata Tatimore informon si vijon: Bazuar në Ligjin nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" i ndryshuar, Neni 21, si dhe në Udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" i ndryshuar, Neni 27, pajisja e vetëshërbimit (automati) detyrohet të kryejë procedurën e fiskalizimit për çdo shitje që realizon përmes kësaj pajisje. Tatimpaguesi nuk ka detyrimin e printimit të faturës së fiskalizuar në letër në rastin e	E kufizuar	Nuk ka

				<p>kryerjes së shitjeve nëpërmjet autometeve, por duhet të afishojë në çdo automat kodin QR ku të shfaqen të dhënat e NIPT-it të tij dhe kodit të pajisjes elektronike të faturimit, që është pajisje vetëshërbimi.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konstaton se ju nuk përfshiheni në kategorinë e autoriteteve të listuara në nenin 24, të cilëve mund t'u ofrohet informacioni tatimor.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se janë kërkuar të dhëna tatimore të subjekteve, për të cilat Administrata Tatimore ka detyrimin ligjor të ruajtjes së konfidencialitetit të tyre në zbatim të nenin 25 "Konfidencialiteti", të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës".</p>		
35	12.06.2023	Denoncim për shmangien e pagesës së kontributeve shoqërore dhe shëndetësore ndaj punëmarrësve si edhe mosdeklarim të pagës reale të tyre.	23.06.2023	<p>Administrata Tatimore sqaron se është e angazhuar në misionin e saj për të identifikuar, verifikuar dhe marrë të gjitha masat e nevojshme në zbatim të ligjit nr. 9920 për "Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, çdo subjekt që shkel ligjin me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve tatimore dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore ndaj punëmarrësve si edhe mosdeklarim të pagës reale të tyre.</p>	E plotë	Nuk ka

				Sa i takon denoncimit tuaj, ju bëjmë me dije se rasti po trajtohet nga strukturat përgjegjëse të Administratës Tatimore, të cilat kanë nisur hetimin dhe kontrollin e thelluar në subjektin që ju përmendi, me qëllim verifikimin e shkeljes së ligjit dhe marrjen e masave konkrete në zbatim të tij.		
36	07.07.2023	1) Sa është numri total i personave të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2022? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 2)Sa është numri total i të rinjve (15-29 vjec) të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2022? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?	10.07.2023	1- Numri total i të vetpunësuarve është 87,432. Nga ku 30,274 janë femra dhe 57,158 meshkuj. 2- Numri total i të vetpunësuarve sipas moshës 15 deri në 29 vjeç është 8,149. Nga ku 2,511 janë femra dhe 5,638 janë meshkuj.	E plotë	Nuk ka
37	12.07.2023	Kërkesë për hetim administrativ/fiskal nga punonjëset e X kompani.	19.07.2023	Administrata Tatimore sqaron se është e angazhuar në misionin e saj për të identifikuar, verifikuar dhe marrë të gjitha masat e nevojshme në zbatim të ligjit nr. 9920 për “Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, çdo subjekt që shkel ligjin me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve tatimore dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore ndaj punëmarrësve si edhe mosdeklarim të pagës reale të tyre. Sa i takon denoncimit tuaj, ju bëjmë me dije se rasti po trajtohet nga strukturat përgjegjëse të Administratës Tatimore, të cilat kanë nisur hetimin dhe kontrollin e thelluar në subjektin që ju përmendi, me	E plotë	Nuk ka

				qëllim verifikimin e shkeljes së ligjit dhe marrjen e masave konkrete në zbatim të tij.		
38	12.07.2023	Ish-punonjës i Tatimeve në Has. Bërë një kërkesë për vërtetim për vjetërsi pune për Pensionin.	20.07.2023	Është kontaktuar me ish-punonjësin dhe është mundësuar vërtetimi i kërkuar.	E plotë	Nuk ka
39	12.07.2023	Informacion lidhur me statusin e 6 personave nëse janë të punësuar apo jo dhe sa muaj kanë paguar kontribute.	13.07.2023	Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik Tatimor, rezulton se të 6 personat rezultojnë të punësuar pranë të njëjtit subjekt, i cili rezulton i regjistruar që nga periudha Janar 2023. Listëpagesat e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për periudhat 2301 - 2306, rezultojnë të deklaruara dhe të dorëzuara në organin tatimor.	E plotë	Nuk ka
40	17.07.2023	Sa biznese të shërbimeve të hoteleri turizmit janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë? 2) Sa janë të ardhurat e deklaruara nga këto biznese për harkun kohor Qershor - Shtator 2022? 3) Sa janë të ardhurat e deklaruara nga këto biznese për harkun kohor Maj - Qershor 2023? 4) Sa është numri i punëtorëve të regjistruar prej tyre gjatë këtyre sezoneve dhe pagesës së detyrimeve tatimore për ta?	20.07.2023	1- Numri në total është 1,666. 2- Numri mesatar i punonjësve Qershor 2022-Shtator 2022 është 11,795 Numri mesatar i punonjësve Maj 2023-Qershor 2023 është 8,511. Përsa i përket pyetjes 2 dhe 3, Administrata Tatimore sqaron se në përputhje me nenin 25 "Konfidencialiteti", të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se: "Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore qendrore dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës."	E kufizuar	Nuk ka

				Ndërkohë, në nenin 24 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht autoritetet me të cilat Administrata tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor. Gjithashtu në këtë nen janë të përcaktuara rastet dhe rrethanat se kur mund të jepet ky informacion.		
41	17.07.2023	Denoncim për moslëshimin e faturës tatimore nga ana e kompleksit X.	27.07.2023	<p>Nga grupi i punës është kryer verifikimi në vend në adresën e deklaruar sipas ankesës që ka denoncuar rastin. Në momentin e kryerjes së kontrollit u konstatua se ushtronte aktivitet shtetasi tatimpagues X me aktivitet Y.</p> <p>Nga verifikimi i kryer në vend rezultoi se: Subjekti është i regjistruar në Organet Tatimore dhe në QKB.</p> <p>Ka të instaluar pajisjen e fiskalizimit dhe lëshon fatura tatimore të fiskalizuara.</p> <p>Në ambientet e subjektit, në momentin e kontrollit, personat të cilët u gjendën në punë rezultojnë të deklaruar në Organet Tatimore.</p> <p>Subjekti dispononte Fatura Tatimore Blerje dhe kishte të afishuar dhe listën e çmimeve e cila përputhet me çmimet reale të shitjes.</p>	E plotë	Nuk ka
42	21.07.2023	Informacion mbi DIVA 2022.	01.08.2023	Nga verifikimi në sistemin tatimor C@ts për individin X, bazuar në ekstraktin historik të punonjësit rezulton se X ka qënë e dypunësuar për periudhën tatimore Shkurt 2022 sipas tabelës bashkëlidhur. Sqarojmë	E plotë	Nuk ka

				<p>se, ju rezultoni e regjistruar në sistemin tatimor për përgjegjësinë e Tatimit mbi të Ardhurat Individuale që prej datës 20.05.2022. Në lidhje me mënyrën e aksesimit të faqes tuaj në e-Filing, po ju vendosim në dispozicion për orientim manualin "Si të regjistrohemi për DIVA", nëpërmjet modulit e-filing dhe linkun përkatës me video ilustruese.</p> <p>https://ëëë.tatime.gov.al/shkarko.php?id=10226</p> <p>Sa më lart, theksojmë se plotësimi i Deklartës mbi të Ardhurat Personale (DIVA) është detyrim Individual që është përcaktuar dhe sanksionuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.</p> <p>Megjithatë, mbështetur në ligjin 9920, datë 19.05.2008 " Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, neni 38 " E Drejta e Ankimimit"</p> <p>nëse ju keni kundërshtime për sa më sipër mund ti drejtoheni Drejtorisë së Apelitit Tatimor pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p>		
43	25.07.2023	"Memorandumin për Bashkëpunimin e Administratave Tatimore në Ballkanin Perëndimor".	03.08.2023	<p>Në zbatim të gërmës "d", të nenit 10 të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", ku parashikohet se:</p> <p>"Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme: d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se</p>	E deleguar	Nuk ka

				autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".		
44	25.07.2023	"Marrëveshjen për Njohjen Reciproke të operatorëve Ekonomik të Autorizuar – Autorizimet për Sigurinë dhe Mbrojtjen (OEAS)".	26.08.2023	Në zbatim të gërmës "d", të nenit 10 të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", ku parashikohet se: "Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme: d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar.	E deleguar	Nuk ka
45	26.07.2023	Me krijimin e nje fondacioni jo fitimprures: 1-A duhet te paisem me programin e fiskalizimit? 2-Drejtori i ketij fondacioni a duhet te derdhi sig shoq -shendetesore? 3-Ne cilin grup kategorizimi per sig.shoq -shendetesore do te perfshihet drejtori i ketij fondacioni?	27.07.2023	Lutemi për krijimin e një organizate jofitimprurëse të konsultoni me ligjet si më poshtë vijon: Ligjin Nr. 80/2021 "PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE". Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre për organizata jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin për t'u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Ligjin 9920, datë 19.05.2008 " Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar; Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve	E plotë	Nuk ka

				shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" i ndryshuar; Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar. Referuar dispozitave ligjore fondacionet, shoqatat, organizatat (të gjithë subjektet jofimprurëse) në zbatim të Nenit 18 "Përgjashtimet" të ligjit Nr. 8438, Datë 28.12.1998, janë të përjashtuar nga Tatimi mbi Fitimin, por i nënshtrohen të gjitha detyrimeve në lidhje me personelin, qoftë ky edhe Bordi Drejtues. Përsa i përket përjashtimeve nga sigurimet shoqërore, shëndetësore duhet ti drejtoheni institucioneve respektive të cilat janë kompetente në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare që përjashtojnë këtë kategori.		
46	02.08.2023	Asistencë për marrjen e Rezidences Tatimore si Individ. Kam aplikuar dy herë në e-Albania.	09.08.2023	Për sistemimin e situatës lutemi të paraqiteni pranë protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për plotësimin e një kërkesë ku kërkonti saktësimin e mbiemrit tuaj.	E plotë	Nuk ka
47	09.08.2023	Lista e bizneseve në zonat vendore sipas Bashkive Shkodër, Dibër, Durrës, Kavajë, Pogradec, Fier, Tepelenë dhe Roskovec.	16.08.2023	Në total rezultojnë 5335 subjekte sipas zonave që mundëm të evidentonim nga popullata. Durrës 93, Fier 3,785, Kavajë 283, Krujë 1, Lushnjë 12, Malsi E Madhe 7, Pogradec 1,110, Shkodër 41, Tepelenë 3.	E plotë	Nuk ka
48	09.08.2023	A ka ndonjë procedurë të vecantë, në lidhje me rimbursimin për projektet e financuara nga Delegacioni European, apo duhet ta	15.08.2023	Për të përfituar rimbursimin e TVSH-së në kuadër të një marrëveshje financiare të ratifikuar nga Kuvendi, në të cilën është parashikuar mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e	E plotë	Nuk ka

		konsiderojmë si jo te rimbursueshme?		<p>tatime, i kontraktuari/përfituesi i grantit, duhet të jetë i regjistruar në organet tatimore shqiptare.</p> <p>Procedura dhe dokumentacioni që nevojitet për rimbursimin TVSH-së, janë të përcaktuar në nenin 63 dhe 63/1 të Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH" i ndryshuar.</p>		
49	15.08.2023	Informacion në lidhje me ndalesat për pension privat nga paga bruto, a duhet të pasqyrohen në listëpagesë në tatime dhe si veprohet në këtë rast?	25.08.2023	<p>Ne lidhje me kërkesen tuaj ju informojmë se: Referuar nenit 8/1 "Te ardhura te perjashtuara" pika 12, te ligjit nr. 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat " i ndryshuar, si dhe pikes 11 te pikes 5.2 "Te ardhura te perjashtuara" te udhezimit nr. 5 date 30.01.2006 i ndryshuar ne zbatim te ligjit, pagesat e kontributeve qe behen nga cdo anetar i nje fondi te pensionit vullnetar deri ne masen e percaktuar ne ligjin per fondet e pensionit vullnetar si dhe pagesat e kontributeve te bera nga punedhenesi ose cdo kontribues tjeter, ne emer dhe per llogari te anetarit te fondit te pensionit vullnetar, jane te perjashtuara nga tatimi mbi te ardhurat personale.</p> <p>Pagesa per fondin e pensionit vullnetar i zbritet te ardhures personale te tatueshme, perpara perlogaritjes se tatimit mbi te ardhurat personale.</p> <p>Ne lidhje me shumen e derdhur si nga anetari ashtu edhe nga punedhenesi, per fondin e pensionit vullnetar, duhet t'i</p>	E plotë	Nuk ka

				referoheni ligjit nr. 10197 date 10.12.2009 "Per fondet e pensionit vullnetar". Per sa i perket pasqyrimin ne liste pagese kjo shume do te pasqyrohet ne rubriken perkatese.		
50	22.08.2023	Më duhen të dhënat për Themeluesin dhe Kryetari/Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës X.	22.08.2023	Në nenin 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave Administrata Tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Ndërsa në nenin 25 "Konfidencialiteti", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet se: "Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës."	E refuzuar	Nuk ka
51	22.08.2023	Ambasada e Japonise: problematikë me qytetar japonez	31.08.2023	Në vijim të kërkesës suaj, sqarojmë se: Nga verifikimi në sistemin tatimor deri më datë 31.08.2023, rezulton se: Subjekti X ka paguar më datë 18.08.2023, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore të periudhës Prill– Maj– Qershor 2023. Ndërkohë që, subjekti X rezulton të ketë detyrimet e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore periudha Korrik 2023 dhe Tatim i Mbajtur në Burim	E plotë	Nuk ka

				<p>periudha Qershor 2023 të papaguar, të cilat janë jashtë afatit ligjor.</p> <p>Theksojmë se: Pagesat e vetme të kryera më datë 18.08.2023 nga ana e subjektit, janë ato të lartpërmendurat, të cilat janë reflektuar tashmë në sistemin tatimor.</p> <p>Referuar të dhënave sipërcituar, ju bëjmë me dije se të gjitha pagesat e kryera nga ana juaj për detyrimet tatimore, janë reflektuar në sistemin C@ts.</p>		
52	07.09.2023	Si janë procedurat për kalimin e një Biznesi të Madh, në Biznes të Vogël me TVSH? Ku duhet të drejtohem?	13.09.2023	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije se në bazë të legjislacionit aktual tatimor në fuqi, nuk lejohet kalimi nga biznes i madh (Regjistruar për Tatim Fitimi) në biznes të vogël (regjistruar për Tatim fitimi të Thjeshtuar). Cfarëdo të jenë arsyet për të cilat tatimpaguesi (biznesi) kërkon që të ndryshojë fashën ku është aktualisht i regjistruar. Lutem për sqarime më të shumta, drejtohuni tek Shërbimi i Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.</p>	E plotë	Nuk ka
53	18.09.2023	Mbi publikimin e të dhënave personale nga Tatime.gov.al, në motorin kërkimit Google.	18.09.2023	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj të mëposhtme, ju sqarojmë se: Ky është një skedar që gjenerohet automatikisht nga sistemi C@TS dhe përmban listen e tatimpaguesve të regjistruar dhe publikohet në faqen e Tatimeve, bashkë me listën e periudhave tatimore dhe kodeve të të ardhurave, si informacion në shërbim të bankave, për të kontrolluar saktësinë e numrit serial të pageses, sipas marrëveshjes së nënshkruar për pagesen e tatimeve në bankat e nivelit të</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>dytë. Informacion përmban NID dhe emer mbiemër. Ky skedar është gjeneruar dhe vazhdon të gjenerohet çdo ditë, që nga viti 2015, kur është vënë në funksionim sistemi C@TS.</p> <p>Në bazë të marrëveshjes të lidhur mes Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Shoqatës së Bankave të nivelit të dytë gjeni mëposhtë listat me informacionin përkatës.</p> <p>https://www.tatime.gov.al/c/8/189/informacion-ne-sherbim-te-bankave</p>		
54	18.09.2023	Kërkesë për punësim. Gëzoj Statusin Person me Aftësi të Kufizuara Fizike	18.09.2023	<p>Lidhur me kerkesen tuaj, ju sqarojme si vijon:</p> <p>Nëse kerkesa juaj është për vendet vakante të punës, të cilat trajtohen me dispozita të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, (Strukturat e Hetimit Tatimor apo Verifikimit dhe Koordinimit në Terren), ju ftojmë të vizitoni faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, http://tatime.gov.al.</p> <p>Për punësim në administratën shtetërore, në pozicione pune të trajtuara me dispozita të nëpunësit civil, duhet të vizitoni për informacion faqen zyrtare www.dap.gov.al, ku pasqyrohen vendet vakante dhe procedura e cila duhet të ndiqet.</p> <p>Lidhur me institucionin e Avokatit të Tatimpaguesit ju bejme me dije se eshte strukture e cila eshte ne Ministrine e</p>	E plotë	Nuk ka

				Financave dhe Ekonomise, dhe jo pjese e Administrates Tatimore Qendrore.		
55	25.09.2023	1) Sa është sasia e qarkullimit vjetor (xhiros) që deklarohen klinikat dentare sipas viteve 2018, 2019, 2020, 2021, 2022? 2) Sa është sasia dhe vlera e implantave dentare të shitur të deklaruara pranë organeve tatimore të implanteve dentare sipas viteve 2018, 2019, 2020, 2021, 2022?	27.09.2023	Viti 2018 është 3,904,868,806. Viti 2019 është 4,802,428,129. Viti 2020 është 4,292,345,608. Viti 2021 është 3,666,186,024. Viti 2022 është 5,989,727,232. Përsa kërkoni më sipër, Administrata Tatimore dëshiron të sqarojë se aktualisht nuk ka një kodifikim unik të artikujve. Si dhe për shkak të larmishmërisë së artikujve dhe shërbimeve në fushën dentare që operojnë, është e vështirë identifikimi i artikujve specifik, për shkak të emërtimeve të ndryshme të përdorura nga tatimpagues të ndryshëm.	E plotë	Nuk ka
56	25.09.2023	Kërkoj të di numrin total të të punësuarëve të deklaruar në administratën tatimore nga X SH.P.K. për periudhën: nëntor 2021; dhjetor 2021, për secilin muaj të 2022 dhe gjatë secilit muaj të 2023 (deri tani), të regjistruar në secilën prej adresave të mëposhtëme (pra, jo së bashku, por sipas selive përkatëse: sa punëtorë të deklaruar për secilën adresë), 1.Adresa X 2.Adresa Y	27.09.2023	Numri i punonjësve deklarohet për total periudhe dhe jo për adresa që ka subjekti. Nëntor 2021 numri i punonjësve deklaruar listëpagesë është 3. Dhjetor 2021 është 6. Janar, Shkurt, Mars 2022 numri është 6. Prill 2022 është 5. Maj-Qershor-Korrik 2022 është 6. Gusht – Shtator-Tetor-Nëntor-Dhjetor 2022 është 7. Janar-Shkurt-Mars-Prill-Maj 2023 është 7. Qershor-Korrik-Gusht 2023 është 8.	E plotë	Nuk ka

		P.S.: Kjo është sipas adresave të regjistruara në QKB, në të cilat operon kompania në fjalë.				
57	11.10.2023	<p>1.Sa të punësuar me kohë të pjesshme ka aktualisht në Shqipëri?</p> <p>2.Cila grupmoshë rezulton si më e punësuar me kohë të pjesshme?</p> <p>3.Cila gjini rezulton si më e punësuar me kohë të pjesshme?</p> <p>4.Sa të punësuar me kohë të plotë ka aktualisht në Shqipëri?</p> <p>5.Sa të punësuar me kohë të pjesshme ka pasur në tre vitet e kaluara? (Të ndara sipas viteve, 2020, 2021, 2022). Po me kohë të plotë?</p>	12.10.2023	<p>1- Sa të punësuar me kohë të pjesshme ka aktualisht në Shqipëri? 47,021</p> <p>2- Cila grupmoshë rezulton si më e punësuar me kohë të pjesshme? Grupmosha ndërmjet 20 dhe 30 vjec</p> <p>3- Cila gjini rezulton si më e punësuar me kohë të pjesshme? Meshkuj</p> <p>4- Sa të punësuar me kohë të plotë ka aktualisht në Shqipëri? 628,998</p> <p>5- Sa të punësuar me kohë të pjesshme ka pasur në tre vitet e kaluara? (Të ndara sipas viteve, 2020, 2021, 2022). Po me kohë të plotë?</p> <p><i>Kohe të pjesshme</i></p> <p>V 2020 Nr: 48,763</p> <p>V 2021 Nr: 46,714</p> <p>V 2022 Nr: 46,556</p> <p> </p> <p><i>Me kohe jo të pjesshme</i></p> <p>V 2020 Nr: 605,625</p> <p>V2021 Nr: 617,821</p> <p>V 2022 Nr: 629,348</p>	E plotë	Nuk ka
58	12.10.2023	Denoncim për një Oficine X në Lushnjë. Punonjë italiane pa leje qëndrimi në Shqipëri, pa sigurime. Ka të punësuar edhe fëmijë nënmoshë. Të gjithë janë pa sigurime.	23.10.2023	<p>Në përgjigje të denoncimit tuaj, për aktivitetin e një subjekti me veprimtari ekonomike "Servis automjetesh", në Lushnjë, ju informojmë sa vijon:</p> <p>Më datë 17.10.2023 nga grupi i punës inspektoreve është kryer kontrolli i verifikimit të aktivitetit veprimtari ekonomike "Servis automjetesh", në Lushnjë</p>	E plotë	Nuk ka

				dhe në momentin e kryerjes së kontrollit rezultoi se ushtronte aktivitet tatimpaguesi X. Subjekti është i regjistruar në Organet Tatimore dhe në QKB. Subjekti ka kryer procesin e Fiskalizimit për lëshimin e faturave elektronike dhe është në kushte punë. Në momentin e kontrollit nuk kishte klient për të shërbyer. Gjithashtu në momentin e kontrollit u konstatuan 2 (dy) punonjës të padeklaruar Organin Tatimor. Për sa më sipër, në bazë të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 119, pika 1, germa b, u mbajt PVGJ në vlerë totale 100.000 lekë gjobë.		
59	12.10.2023	Jam një student Juridiku që gëzoj Statusin Person me Aftësi të Kufizuara Fizike. Do doja të merrja informacion në lidhje me Tatueshmërinë dhe Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore në dy raste specifike. 1) Hapja e një brendi orash dhe syzesh (gjithmonë nëse aprovohet kërkesa për hapjen e nje dyqani te autorizuar ne qyetin ku unë banoj) 2) Hapja e një zyre konsulence juridike me profil civil pa (përfaqësim në gjykatë) dmth përpilim kontratash ankime,	31.10.2023	Së pari z.X duhet të informohet tek instituti i Sigurimeve Shoqërore, pasi me hapjen e nje aktiviteti tregtar mund të humbase KEMP - in (të ardhurat e perfituara nga KEMP). Se dyti perpara se nje individ te filloje ushtrimin e veprimtarise ekonomike (ofrim mallra apo sherbime/person fizik apo juridik), duhet te regjistrohet ne QKB. Ne zbatim te dispozitave te Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar si dhe Udhezimi nr.32, date 31.12.2013 "Per tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel", i ndryshuar, tatimpaguesit (person fizik apo jurike) qe ushtrojne veprimtari ekonomike me xhiro deri 8,000,000 leke/vit jane tatimpagues te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin. Personi Fizik (i vetepunesuar i vetem) me xhiro deri	E plotë	Nuk ka

		apo plotësim kriteresh dhe dokumentesh për licensim. Cilat janë lehtësirat dhe pengesat e të konvertuara në kosto financiare për mua si person fizik.		8,000,000 leke/vit (ofrim mallra apo sherbime) ka 0% tatim te thjeshtuar mbi fitimin, por duhet te paguaje sigurime shoqerore dhe shendetesore, ne zbatim te dispoziteve te VKM 77, 28.01.2015 "Per kontributet e detyrueshme dhe perfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqerore dhe sigurimin e kujdesit shendetesor", i ndryshuar pika 6, kapitulli III "Llojet, shuma dhe shperndarja e kontributeve": <ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurime te detyrueshme shoqerore 23% te pages minimale per efekt sigurimi (23% * 40,000 leke/muaj) 2. Sigurime te detyrueshme shendetesore 3,4% te dyfishit te pages minimale per efekt sigurimi (3.4% * 80,000 leke/muaj). 		
60	12.10.2023	A është Booking i regjistruar si subjekt në Shqipëri, për të paguar kështu TVSH-në? -Sa do të jetë norma e TVSH-së që Booking do të paguajë? - TVSH do të paguhet sipas çmimit të listuar apo mbi 15%? - Duke qenë se Booking është seli e regjistruar në Holandë, a preket nga marrëveshjet e tatimit të dyfishtë? - Mund të sjellë kjo një rritje të çmimeve në tregun e qirave afatshkurtra në vend?	25.10.2023	Lidhur me kërkesen tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 9, dhe Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 86, 87, për pagesën e TVSH-së, tatimpaguesi jorezident emëron një përfaqësues tatimor rezident, i cili ka të drejte të veproje në emër të tij. Shkalla tatimore që aplikon Përfaqësuesi Tatimor për llogari të tatimpaguesit jorezident është 20%, për çdo shërbim të ofruar ndaj personave të patatueshëm (individ) në R.SH.	E plotë	Nuk ka

				Tatimpaguesit rezidentë tatimorë shqiptarë, të cilët gjatë vitit kryejnë transaksione me persona rezidentë në shtete me të cilat Shqipëria ka Marrëveshje Tatimore në fuqi, dhe këto marrëveshje parashikojnë aplikimin e përjashtimeve apo tarifave të reduktuara sipas dispozitave të Marrëveshjes Tatimore përkatëse, mund të aplikojnë pranë administratës tatimore për Zbatimin e Marrëveshjeve për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë.		
61	12.10.2023	1) Sa ka qenë numri i punonjësve për vitet 2020-2023 në hoteleri dhe turizëm? 2) Sa kanë qenë punonjësit sezonal në hoteleri dhe turizëm në këto vite?	25.10.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj, lutemi gjeni si më poshtë numrin mesatar të punonjësve për Subjektet Akomodim - Hoteleri , Bar-Restorante, sipas viteve: Numri mesatar i punonjësve viti 2020 – Totali 47,144 Numri mesatar i punonjësve viti 2021 – Totali 47,854 Numri mesatar i punonjësve viti 2022 – Totali 47,955 Numri mesatar i punonjësve viti 2023- Totali 57,698 Përsa i përket punonjësve sezonale nuk disponohet një kategori e veçantë për punonjësit sezonal, por gjatë Qershor 2023 janë rreth 11,029 punonjës, të cilët mund të kenë punuar me kohë të pjesshme.	E plotë	Nuk ka
62	12.10.2023	Individët që ofrojnë trajnime dhe seminare me pagesë si Freelancers, në fushën e zhvillimit të aftësive personale, si të folurit në	30.10.2023	Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju bëjmë me dije si vijon: Së pari sqarojmë se, në thelb, freelancing është një punë e pavarur ku një person punon për veten e tij, e jo për një kompani	E plotë	Nuk ka

		<p>publik dhe komunikim, a nevojitet të regjistrohen në DPT? Në rast se po, cila është procedura që duhet të ndjekin? A mundet një person që është i punësuar në një subjekt, të ushtroj edhe aktivitet si freelancer? Në rast se po, si përlogariten taksat që duhet të paguajë një freelancer dhe cilat janë kushtet për të ushtruar këtë aktivitet?</p>		<p>të caktuar. Për sa shkruani mund të kemi dy raste:</p> <p>1. Individit është freelance dhe jep shërbime në mënyrë rastësore për tatimpagues rezidente në Republikën e Shqipërisë (RSH) apo jorezidentë.</p> <p>- Në rast se shërbimet jepen për tatimpagues rezidentë në RSH, për pagesat që do i jepen individit do të mbahet tatimi në burim në masën 15% të shumës (pagesës), referuar nenit 33 "Mbajtja në burim e tatimit" të ligjit nr.8438, date 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.</p> <p>- Në rast se pagesa kryhet nga një jorezident në RSH, Individit do të deklarojë këto të ardhura në DIVA të vitit përkatës kur janë përfituar, duke kredituar tatimin e paguar jashtë RSH (nëse është paguar) deri në masën e parashikuar në dispozitet e ligjit vendas (15%).</p> <p>2. Individit jep shërbime si freelancer në mënyrë të vazhdueshme:</p> <p>- Pavarësisht se është i punësuar, ai është i detyruar të regjistrohet si tatimpagues që ushtron veprimtari ekonomike (Person Fizik) dhe duhet të regjistrohet online në Qendren Kombëtare të Biznesit. Në këtë rast, në varësi të qarkullimit (xhiros së deklaruar), përcaktohen edhe përgjegjësitë tatimore të subjektit.</p>		
63	20.10.2023	1)Kur dhe ku lëshohet kuponi tatimor? 2) Faqet online, a	31.10.2023	Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të	E plotë	Nuk ka

		<p>duhet të lëshojnë kupon tatimor edhe për blerësit, në momentin e dorëzimit të pakos së blerë? 3)Sa faqe online janë gjobitur për mos lëshim kuponi tatimor? Po biznese fizike?</p>		<p>Qarkullimit", nuk lëshohet kupon tatimor por faturë. Tatimpaguesit janë të detyruar lëshojnë faturë për çdo furnizim malli ose shërbimi që është pjesë e veprimtarisë së tyre ekonomike. Fatura duhet të lëshohet në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në ligj. Për më tepër informacion lidhur me lëshimin e faturës, ju lutem referohuni në legjislacionin e publikuar në Web site e institucionit të Tatimeve. Bashkëlidhur linku: https://www.tatime.gov.al/c/424/431/baza-ligjore Në vijim të përgjigjes si më sipër, ku theksojmë se në zbatim të ligjit 87/2019 subjektet tatimpagues të regjistruar në organin tatimor për çdo transaksion (shitje malli / shërbimi) me ose pa para në dorë kanë detyrimin e lëshimit të faturës tatimore të fiskalizuar. Administrata Tatimore nuk e përkufizon si të ndarë dhe nuk ka asnjë ndryshim ushtrimi i aktivitetit ekonomik në ambient fizik apo faqe online, pasi çdo subjekt që operon në RSH mund të zgjedhi të reklamojë produktet që ofron në medime të ndryshme, përfshirë këtu edhe faqet online. Në lidhje me penalitetet, vlen të përmendim se kontrollet dhe verifikimet kryhen mbi bazën e analizës së riskut dhe nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren gjatë</p>		
--	--	---	--	--	--	--

				<p>periudhës 2022- Shtator 2023 janë penalizuar 257 tatimpagues për moslëshim fature tatimore të fiskalizuar. Qëllimi i Administratës Tatimore nuk është penalizimi i tatimpaguesve, por ndërgjegjësimi i tyre për vetpërbushje.</p>																						
64	23.10.2023	<p>Sa të punësuar ka aktualisht në Shqipëri? Po vjet në këtë periudhë sa ishin?</p> <p>2. Cilët janë 5 profesionet që kanë numrin më të lartë të punonjësve aktualisht në Shqipëri? *shifrat e ndara sipas profesioneve</p> <p>3. Cilët janë 5 profesionet që kanë numrin më të ulët të punonjësve aktualisht në Shqipëri? *shifrat e ndara sipas profesioneve</p> <p>4. Sa pensionistë rezultojnë aktualisht të punësuar? Po në vitin 2022 dhe 2021 sa ishin?</p> <p>5. Aktualisht janë më shumë gra apo burra pensionistë të punësuar?</p> <p>6. Cilët janë profesionet ku ka më shumë pensionistë të punësuar aktualisht?</p>	26.10.2023	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:</p> <p>1. Sa të punësuar ka aktualisht në Shqipëri? 721,967 të punësuar Po vjet në këtë periudhë sa ishin? 712,856 të punësuar</p> <p>2. Cilët janë 5 profesionet që kanë numrin më të lartë të punonjësve aktualisht në Shqipëri? *shifrat e ndara sipas profesioneve.</p> <table border="1"> <tr> <td>39,101</td> <td>Shitës në dyqan</td> </tr> <tr> <td>22,398</td> <td>Administrator</td> </tr> <tr> <td>13,660</td> <td>Kamarier</td> </tr> <tr> <td>13,499</td> <td>Punëtor krahu</td> </tr> <tr> <td>13,397</td> <td>Punëtor ndihmës</td> </tr> </table> <p>3. Cilët janë 5 profesionet që kanë numrin më të ulët të punonjësve aktualisht në Shqipëri? *shifrat e ndara sipas profesioneve.</p> <table border="1"> <tr> <td>1</td> <td>Artist imitues</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Asistent shëndetësore i komunitetit</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Bakteriolog për produktet ushqimore</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Bashkues tubash</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Dirigjent grupi vokal</td> </tr> </table>	39,101	Shitës në dyqan	22,398	Administrator	13,660	Kamarier	13,499	Punëtor krahu	13,397	Punëtor ndihmës	1	Artist imitues	1	Asistent shëndetësore i komunitetit	1	Bakteriolog për produktet ushqimore	1	Bashkues tubash	1	Dirigjent grupi vokal	E plotë	Nuk ka
39,101	Shitës në dyqan																									
22,398	Administrator																									
13,660	Kamarier																									
13,499	Punëtor krahu																									
13,397	Punëtor ndihmës																									
1	Artist imitues																									
1	Asistent shëndetësore i komunitetit																									
1	Bakteriolog për produktet ushqimore																									
1	Bashkues tubash																									
1	Dirigjent grupi vokal																									

				<p>4. Sa pensionistë rezultojnë aktualisht të punësuar? Moshë e dalje në pension për femrat llogaritet në 61 vjeç Moshë e dalje në pension për meshkujt llogaritet në 65 vjeç Në vitin 2023 - 17,525 Në vitin 2022 - 23,949 Në vitin 2021 - 31,276</p> <p>5. Aktualisht janë më shumë gra apo burra pensionistë të punësuar? Janë më shumë burra</p> <p>6. Cilët janë profesionet ku ka më shumë pensionistë të punësuar aktualisht?</p> <table border="1"> <tr><td>Administrator</td></tr> <tr><td>Shitës në dyqan</td></tr> <tr><td>Roje</td></tr> <tr><td>Shofer</td></tr> <tr><td>Punëtor krahu</td></tr> <tr><td>Ekonomist</td></tr> <tr><td>Sanitar</td></tr> <tr><td>Banakier</td></tr> </table>	Administrator	Shitës në dyqan	Roje	Shofer	Punëtor krahu	Ekonomist	Sanitar	Banakier		
Administrator														
Shitës në dyqan														
Roje														
Shofer														
Punëtor krahu														
Ekonomist														
Sanitar														
Banakier														
65	24.10.2023	Emisioni X ka publikuar investigimin për noteren Y në Tiranë. Investigimi evidentoi fshehjen e të ardhurave të noteres, ku u konstatun me fakte shuma marramëndese që noteria kishte fshehur për vitin 2022.	03.11.2023	<p>Në përgjigje të e-mail tuaj, ju bëjmë me dije se: Administrata Tatimore është e angazhuar në misionin e saj për të identifikuar, verifikuar dhe marrë të gjitha masat e nevojshme në zbatim të ligjit nr. 9920 për "Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, çdo subjekt që ushtron aktivitet</p>	E plotë	Nuk ka								

		<p>1. A është nisur ndonje hetim për këtë rast nga struktura e Hetimi Tatimor?</p> <p>2. Nqs po,në çfarë fazë ndodhet dhe masat që janë referuar tek organet kompetente?</p>		<p>ekonomik në kundërshtim me legjislacionin tatimor.</p> <p>Sa i takon denoncimit tuaj në lidhje me noteren X, ju bëjmë me dije se rasti në fjalë po trajtohet nga strukturat përgjegjëse të Administratës Tatimore, të cilat kanë nisur hetimin në subjektin që ju përmendi, me qëllim verifikimin e shkeljes së ligjit dhe marrjen e masave konkrete në zbatim të tij.</p>		
66	31.10.2023	<p>1) Sa është në total numri i strukturave të regjistruara për qira fatshkurtër në platformat Booking, AirBnb etj? 2) Sa janë në total të ardhurat e gjeneruara nga këto struktura? 3) Sa prej tyre janë të formalizuara? 4) Si do të zbatohet nisma për formalizimin e këtyre strukturave duke përfshirë bashkëpunimin me Booking për zbatimin e ligjit të TVSH-së? Çfarë parashikon ajo konkretisht? Sa të ardhura pritet të arkëtohen?</p>	13.11.2023	<p>Lidhur me pyetjet tuaja, ku kërkonte të dhëna mbi numrin në total të strukturave të regjistruara për qira afatshkurtër në platformat Booking, AirBnb, sa janë të ardhurat e gjeneruara nga këto struktura dhe sa prej tyre janë të formalizuara, ju informojmë se platformat Booking dhe AirBnb nuk administrohen nga Administrata Tatimore dhe për rrjedhojë për informacionin që kërkonte mund t'i drejtoheni këtyre platformave.</p> <p>Ndërkohë, theksojmë se, një nga misionet e Administratës Tatimore është lufta ndaj informalitetit dhe evazionit fiskal. Administrata Tatimore është maksimalisht e angazhuar për të luftuar evazionin në këtë sektor të veçantë, bazuar në të gjithë kuadrin ligjor dhe mundësisë që ofron legjislacioni vendas.</p> <p>Administrata Tatimore ka ndërmarrë hapa konkret për formalizimin e këtij sektori, i cili për shkak të natyrës së veçantë të ofrimit të shërbimit kërkon bashkëpunim</p>	E plotë	Nuk ka

				ndërinstitucional jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.		
67	14.12.2023	1.Sa është në total numri i të punësuarve në kompanitë call center për 2023? Po numri i kompanive? 2.Sa ishte numri i të punësuarve në 2021, në 2022, gjithashtu edhe numri i kompanive i ndare në vite për 2021 dhe 2022?	18.12.2023	<p>Numri mesatar punonjësve/muaj për vitin 2021 - 14,172 Numri i tatimpaguesit aktiv për vitin 2021 – 566</p> <p>Numri mesatar punonjësve/muaj për vitin 2022 - 11,452 Numri i tatimpaguesit aktiv për vitin 2022 - 523</p> <p>Numri mesatar punonjësve/muaj për vitin 2023 (10 mujori) - 9,894 Numri i tatimpaguesit aktiv për vitin 2023 (10 mujori) - 466</p>	E plotë	Nuk ka
68	20.12.2023	Në gazetën X kanë mbërritur dhjetra denoncime për kompaninë Y për shitje pa faturë dhe për mosdeklarim. Kompania në fjalë për vitin financiar 2022 dhe bilancet paraardhëse nuk ka bërë asnjë dorëzim të pasqyrave financiare. Denoncimet e ardhura në redaksi tregojnë se edhe produktet e shitura, jepen pa kupon tatimor, ndërkohë që punonjesit e kompanisë Y punojnë në të zezë. Ju si institucion i keni skanuar	08.01.2024	<p>Përrshëndetje,</p> <p>Në përgjigje të dy e-mail tuaj dërguar në adresën e Zyrës së Shtypit, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Administrata Tatimore është e angazhuar në misionin e saj për të identifikuar, verifikuar dhe marrë të gjitha masat e nevojshme në zbatim të ligjit nr. 9920 për “Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, çdo subjekt që ushtron aktivitet ekonomik në kundërshtim me legjislacionin tatimor.</p> <p>Sa i takon denoncimit tuaj në lidhje me kompaninë Y, ju bëjmë me dije se rasti në fjalë po trajtohet nga strukturat përgjegjëse të Administratës Tatimore, të cilat kanë nisur</p>	E plotë	Nuk ka

		ndonjeherë bilancet e kësaj kompanie? Çfarë masash keni marrë?		hetimin e thelluar në subjektin që ju përmendi, me qëllim verifikimin e shkeljes së ligjit dhe marrjen e masave konkrete në zbatim të tij.		
69	26.12.2023	Sa janë individët që paguhen dhe taten me euro? Sa janë biznest? Sa kanë qënë për vitin 2020 e deri më sot (si kanë ndryshuar)? Sa kanë qënë tatimet e mbledhura nga të ardhurat në euro?	03.01.2024	Përsëritet, Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se: Në zbatim të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 6 pika 5, çdo subjekt tatimpagues që ushtron aktivitetin e tij ekonomik në Republikën e Shqipërisë, deklaron dhe paguan tatime në monedhën kombëtare. Pavarësisht se monedha funksionale e subjektit mund të jetë monedhë të huaj (Euro, Dollarë etj...), detyrimet tatimore pranë Administratës Tatimore llogariten dhe paguhen në monedhën kombëtare. Ju faleminderit për bashkëpunimin,	E plotë	Nuk ka

Shënim: (1) Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

(2) Data e regjistrimit të kërkesës.

(3) Përmbledhje e objektit të kërkesës duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(4) Data e kthimit të përgjigjes.

(5) Përmbajtja e përgjigjes duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(6) Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

(7) Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik